



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

### VENDIM

Nr. 317, datë 19.12.2019

### PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR HARTIMIN E NJË PLANI VEPRIMESH LIDHUR ME REDUKTIMIN E ÇËSHTJEVE TË PRAPAMBETURA DHE RRYTJEN E EFIKASITETIT NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë i Gjyqësor bazuar në nenet 62, pika 14 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 7, 36 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, si dhe në Planin e Veprimit të Strategjisë së KLGJ-së për periudhën Janar 2019-Dhjetor 2020, miratuar me vendimin nr. 126, datë 19.07.2019, me qëllim marrjen e masave emergjente për uljen e numrit të lartë të stokut të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Lartë,

### VE ND O S I :

- I.** Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimi lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë, me këtë përbërje:
  1. Z. Medi Bici Kryetar - Komisioni Disiplinor/Komisioni Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit
  2. Znj. Brunilda Kadi anëtare - Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale
  3. Z. Alban Toro anëtar - Komisioni për Zhvillimin e Karrierës;
- II.** Në mbledhjet e këtij komisioni ftohen të marrin pjesë përfaqësues të Gjykatës së Lartë, të Misionit EURALIUS V, dhe të projektit “Drejtësi për të gjithë”-USAID.
- III.** Ushtrimi i veprimtarisë së komisionit fillon nga data 6 janar deri më 31 mars 2020, afat brenda të cilit, komisioni duhet të depozitojë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor planin e përgatitur në funksion të qëllimit për të cilin është ngritur.
- IV.** Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi kryetari i këtij komisioni dhe anëtarët e tij. Në përmbushjen e punës së tij komisioni do të asistohet nga stafi administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**